

Në bazë të nenit 7, alineja 9 të Ligjit për themelimin të Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Maqedonisë nr. 72/07 dhe 5/09), Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural shpall

THIRRJE PUBLIKE nr. 03/2013
për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzim të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2013

I. LËNDA E SHPALLJES

Lëndë e kësaj shpallje është ndarja e përkrahjes financiare për masat në vijim:

<i>Kodi i masës</i>	<i>Emri i masës</i>	<i>Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme</i>
322	Rinovim dhe zhvillim të fshatrave	Deri më 20.000.000,00 denarë
1	Përpunimi i planeve urbanistike për vendbanimet – fshatra	
2	Investime për ndërtim dhe/ose rikonstruim të rrugëve të fshatit (duke përfshirë edhe kanalizim atmosferik dhe elemente për këmbësorë) në gjatësi deri në 1 km	
3	Investime për ndërtim dhe/ose rikonstruim të shesheve, sipërfaqeve të gjelbra, dhe/ose shëtitoreve në mjedise rurale deri më 30.000 banorë	
323	Mbrojtje dhe avancim të vlerave tradicionale në rajonet rurale	Deri më 15.000.000,00 denarë
1	Investime në infrastrukturën rrugore lokale (duke përfshirë edhe urat) për lidhjen e vendbanimeve - fshatrave me lokalitetin me rëndësi për mënyrën e jetës dhe punën e popullatës së fshatit në gjatësi deri më 2 km rrugën rajonale ose me vendbanimin – qytetin në largësi deri 7 km.	
2	Shënim të monumenteve kulturore dhe natyrore në mjediset rurale	
3	Të shënuarit dhe rregullimi i shtigjeve për alpinizëm dhe të biçikletave	
4	Rregullimi i vendeve për verime në mjediset rurale (duke përfshirë edhe furnizimin e tyre me energji elektrike, furnizimi me ujë, kanalizim)	

II. SHFRYTËZUES

Të drejtë për shfrytëzimin e mjeteve kanë subjektet në vijim, edhe atë për masat:

<i>Subjektet</i>	<i>MASA</i>
Njësitë e vetëqeverisjes lokale – rajoni rural dhe Njësitë e vetëqeverisjes lokale në territorin e së cilës gjendet mjedisi rural për të cilin dedikohet investimi.	322
Njësitë e vetëqeverisjes lokale – rajoni rural dhe Njësitë e vetëqeverisjes lokale në territorin e së cilës gjendet mjedisi rural për të cilin dedikohet investimi. Agjencia për promovim dhe mbështetje të turizmit në Republikën e Maqedonisë me shumë të përgjithshme për shpenzimet e ndërmarra dhe të realizuara të pranueshme deri më 25.000.000 denarë (alinetë 2,3,4)	323



III SHUMA E PËRKRAHJES FINANCIARE

Mjetet janë të dedikuara për investime për furnizim të mjeteve të reja themelore, harxhime operative në lidhje me mjetet e furnizuara dhe harxhime të tjera të parapara me Programin për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2013.

Përkrahja financiare për masën 322, 323 është 100% nga shuma e shpenzimeve të pranueshme, mjetet me kërkesë të shfrytëzuesit mund të ndahen në lloj të pagesës avance në shumë prej 20% të vlerës së shpenzimeve të lejuara të pranueshme ose në pajtim me fazat e realizimit të investimit në bazë të situatave kohore nga mbikëqyrja ose dokumentacionit për furnizim të pajisjes.

Përkrahja financiare për masën **322, 323** u paguhet shfrytëzuesve të cilët më herët kanë paguar pjesën nga vlera e investimit që ka të bëjë me harxhimet e papranueshme (duke përfshirë edhe tatimet) të operatorit ekonomik me të cilin kanë lidhë marrëveshje për furnizime publike për investimin e caktuar.

IV. KUSHTET PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI I CILI DUHET TË DORËZOHET

Një shfrytëzues dorëzon kërkesë origjinale për secilën masë. Një shfrytëzues mund të dorëzojë një kërkesë për shfrytëzim të përkrahjes nga ky program.

Njësitë i vetëqeverisjes lokale pas nënshkrimit të marrëveshjes për përkrahje financiare me APFBZH, janë të obliguar të realizojnë procedurë tenderuese për investimin e planifikuar në pajtim me Ligjin për furnizime publike.

Kushtet të cilat duhet ti plotësojnë kërkuessit e mjeteve janë përcaktuar në Ligjin Programin për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2013, Rregulloren për kriteret më të përafërta për zgjedhje të shfrytëzuesve për masat për zhvillim rural dhe Rregulloren për kushtet shtesë më të përafërta për përkrahjen nga masat për zhvillim rural, shpenzimet e pranueshme dhe shuma e përkrahjes për shpenzimet e pranueshme për shfrytëzues për masë veç e veç.

Kërkuessit të cilët kanë plotësuar kushtet për shfrytëzimin e mjeteve për masat rangohen me pikë të përcaktuar në Rregulloren për kriteret më të përafërta për zgjedhje të shfrytëzuesve sipas masave për zhvillim rural.

V. MARRJA E FORMULAREVE DHE UDHËZIMEVE

Formulari – Kërkesa për shfrytëzim të mjeteve së bashku me listën e dokumenteve të nevojshme dhe Udhëzimin e shfrytëzuesve mund të merret në ueb faqen e Agjencisë www.ipardpa.gov.mk, dhe në qendrat më të afërta rajonale ose njësitë e punës së Agjencisë për nxitje të zhvillimit në bujqësi çdo ditë pune prej ora **8:30 deri në ora 16:30**.

Formularët e lartpërmendur mund të merren edhe drejtpërdrejtë në Agjenci në adresë:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural,
Bul. “3-ta Makedonska Brigada” nr. 20
(ndërtesa e Makedonija Tabak blloku C)
1000 Shkup

VI. MËNYRA E DORËZIMIT TË DOKUMENTEVE

Kërkesat e plotësuara për shfrytëzim të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare për zhvillim rural për vitin 2013 në gjuhën maqedonase së bashku me tërë dokumentacionin e duhur dorëzohen në zarf të mbyllur me shënim në këndin e majtë lart të anës së përparme të zarfit “MOS HAP” për Thirrjen publike nr. 03/2013 dhe shënimin e shifrës së masës/nën sektor për të cilën dorëzohet kërkesa. Kërkesa mund të dorëzohet përmes postës ose personalisht në arkivin e Agjencisë, në të kundërtën Agjencia nuk merr përgjegjësi për humbjen apo hapjen e parakohshme të kërkesës.

Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave është **08.07.2013**. Kërkesat e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të merren në shqyrtim.

Informata më të hollësishme në kontakt tel. (02) 3097-460 ose në kontakt e-mail adresën: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk dhe në ueb faqen: www.ipardpa.gov.mk.

Kontakt:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, Sektori për lejim të projekteve.

Telefoni 02 3097-460, çdo ditë pune prej ora **10.00** deri në ora **16.00**

e-mail: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk